

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Ap – KŽ – 108/2010
25 nëntor 2010
Prishtinë

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Martti Harsia si Kryetar i kolegjit, me Gjyqtarët e EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger dhe Lars Dahlstedt dhe Gjyqtarët e Gjykatës Supreme Marije Ademi dhe Nesrin Lushta si anëtarë të kolegjit, të asistuar nga Zyrtari Ligjor i EULEX-it Sampsa Hakala si procesmbajtës,

Në lëndën penale kundër të pandehurit **Idriz Gashi**, [] i lindur më [] [], vendlindja [], emri i të atit [] emri dhe mbiemri i vajzërisë së ëmës []; vendbanimi i fundit në [] Suedi, [] tani i mbajtur në paraburgim,

I dënuar nga Gjykata e Qarkut në Pejë për vepër penale të **Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile**, në kundërshtim të Nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Neneve 3 dhe 147 të Konventës së Katërt të Gjenevës dhe Nenit 4 të Protokollit të II-të shtesë të Konventave të Gjenevës lidhur me vrasjen e S [] të kryer në vendin Lugu i Isufit, në afërsi të fshatit Vranoc, Komuna e Pejës, me 12 gusht 1998,

Duke vepruar mbi ankesën e të pandehurit të paraqitur përmes Avokatit të tij mbrojtës Mahmut Halimi më 16 shkurt 2010 kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë në lëndën me numër P. nr. 329/2009, të datës 19 nëntor 2009, me anë të së cilit Gjykata e Qarkut shpalli të pandehurin fajtor dhe e dënoi atë me 14 vjet burgim.

Pas mbajtjes së seancës së hapur për publik më 23 nëntor 2010, në praninë e Prokurorit të Shtetit të përfaqësuar nga Kryeprokurori i EULEX-it Jakob Willaredt, Avokatit mbrojtës Mahmut Halimi dhe vetë të pandehurit, dhe pas këshillimit dhe votimit të mbajtur në të njëjtën ditë më 23 nëntor 2010,

Më 25 nëntor 2010, në përputhje me Nenin 392 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), shpall publikisht dhe në prani të Avokatit mbrojtës Betim Shala dhe të prokurorit të EULEX-it, këtë

AKTGJYKIM

Ankesa e paraqitur në emër të të pandehurit Idriz GASHI kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë në lëndën P. nr. 329/2009, të datës 19 nëntor 2009, REFUZOHET si e pabazuar. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë vërtetohet.

ARSYETIMI

I HISTORIA E PROCEDURËS

Hetimet penale kundër Idriz Gashit për vrasjen e S. A. ish-in nisur më 30 shtator 2005.

Më 8 shkurt 2007 Prokurori Publik Ndërkombëtar paraqiti një aktakuzë kundër Idriz Gashit për vepër penale Krime të Luftës kundër Popullatës Civile, në kundërshtim të Nenit 142 të KPRSFJ-së. Kjo pikë e aktakuzës u konfirmua nga Gjykata e Qarkut në Pejë më 23 mars 2007. Aktakuza e paraqitur përfshinte edhe një pikë të Vrasjes së rëndë, pikë të cilën e hodhi poshtë gjykata e qarkut.

Shqyrtimi i parë gjyqësor u mbajt gjatë muajve maj dhe qershor 2007 në Gjykatën e Qarkut në Pejë. Me aktgjykimin e shpallur më 22 qershor 2007 Gjykata e Qarkut në Pejë shpalli të pandehurin Idriz Gashi fajtor dhe e dënoi atë me 15 vjet burgim. I pandehuri ka paraqitur ankesë ndaj këtij aktgjykimi dhe pas vendosjes mbi këtë ankesë Gjykata Supreme konstatoi se gjykata e shkallës së parë kishte shkelur rregullat e procedurës penale duke pranuar dëshminë e dëshmitarit A pa i ndjekur formalitetet ligjore të përcaktuara për të ashtuquajturin dëshmitar bashkopunues. Si pasojë e kësaj Gjykata Supreme ktheu lëndën prapa për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Aktvendimi i përmendur i Gjykatës Supreme u lëshua më 2 qershor 2009.

Më 15 tetor 2009 Prokurori i EULEX-it i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) vendosi t'i ndërpresë hetimet penale kundër personit të lartpërmendur me emrin A i cili ishte dëgjuar si dëshmitar gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor.

Rigjykimi u mbajt në Gjykatën e Qarkut në Pejë gjatë tetorit dhe nëntorit 2009 në praninë e të pandehurit, avokatit të tij mbrojtës, Prokurorit Special dhe njëres palë të dëmtuar. Më 19 nëntor 2009 Gjykata e Qarkut në Pejë shpalli vendimin e saj duke shpallur të pandehurin fajtor për Krime të Luftës kundër Popullatës Civile dhe e dënoi atë me 14 vjet burgim.

Aktgjykimi iu dorëzua të pandehurit Idriz Gashi personalisht më 1 shkurt 2010.

Më 16 shkurt 2010 avokati mbrojtës Mahmut Halimi paraqiti ankesë në emër të të pandehurit kundër aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Më 9 mars 2010 Prokurori i PSRK-së paraqiti përgjigje ndaj ankesës së të pandehurit dhe mendimi dhe propozimi i Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës (ZPSHK), të përfaqësuar nga Prokurori i EULEX-it, u pranua në Gjykatën Supreme më 25 maj 2010.

II ANKESA E MBROJTJES DHE PËRGJIGJA E PROKURORISË

Ankesa e avokatit Mahmut Halimi kundërshton aktgjykimin e shkallës së parë në disa arsye. Avokati mbrojtës propozon se duhet të hidhen poshtë akuzat ndaj të pandehurit dhe se i pandehuri duhet të shfajësohet dhe të lirohet nga paraburgimi. Në anën tjetër avokati mbrojtës propozon që aktgjykimi i shkallës së parë duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

Arsyet e paraqitura për ankesë janë përmbledhur si në vijim:

- Së pari: aktgjykimi i ankimuar ishte bazuar në dëshmi të papranueshme sa i përket deklaratës së dhënë nga dëshmitari A që sipas ankesës përbën shkelje të dispozitave të procedurës penale të përcaktuara me Nenin 403 paragrafi 1 pika 8 e KPPK-së.
- Së dyti: dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk përmban përcaktim të saktë të veprës penale dhe arsyetimi i këtij aktgjykimi është i paqartë dhe kundërthënës sa i përket besueshmërisë së deklaratave të dëshmitarëve në kundërshtim me nenin 403 paragrafi 1 pika 12 e KPPK-së.
- Përveç kësaj ankesa pretendon se arsyeja e parë dhe e dytë e ankesës siç përmendet më lart janë në mospërputhje me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 2 qershor 2009, me anë të së cilit Gjykata Supreme kishte kthyer lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.
- Së treti: ankesa pohon se gjendja faktike ishte vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë. Ankesa këmbëngul se Idriz Gashi nuk është fajtor për vrasjen e S . Ankesa argumenton se gjykata e shkallës së parë bëri gabim në mënyrën se si vlerësoi dhe mbrojtja përmbajtjet e deklaratave të dëshmitarëve. Në veçanti ankesa kundërshton besueshmërinë e deklaratës së dëshmitarit A
- Si arsye të katërt dhe të fundit për ankesë mbrojtja pretendon në shkelje të ligjit penal në aktgjykimin e shkallës së parë siç përcaktohet me nenin 404 të KPPK-së. Megjithatë, mbrojtja nuk e ka shtjelluar këtë arsye.

Prokurori i PSRK-së me përgjigjen e tij thotë se ankesa është e pabazuar dhe se duhet të refuzohet. Prokuroria argumenton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban asnjë shkelje të dispozitave të procedurës penale. Dispozitivi dhe arsyetimi në mbështetje të tij i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore. Përveç kësaj, nuk ka asnjë mospërputhje në mes aktgjykimit të ankimuar dhe aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 2 qershor 2009, që udhëzoi rigjykimin. Prokurori pohon se kishte dëshmi të mjaftueshme për të mbështetur dënimin dhe se vërtetimet faktike ishin shpjeguar qartë dhe ishin mbështetur nga dëshmitë dhe se ishin bërë vlerësime të arsyeshme të besueshme nga gjykata e shkallës së parë.

Prokurori i Shtetit në mendimin dhe propozimin e tij argumenton se ankesa e të pandehurit është e pabazuar, dhe kështu shtyn Gjykatën Supreme ta refuzojë atë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Prokurori i Shtetit konstaton se aktgjykimi i gjykatës së qarkut nuk përmban asnjë shkelje të pretenduar në ankesë. Në mendimin e Prokurorit të Shtetit dispozitivi qartë thekson cilësimin juridik dhe veprimin për të cilin i pandehuri është shpallur fajtor. Përveç kësaj, dispozitivi mbështetet

plotësisht nga gjetjet faktike dhe vlerësimi i dëshmive siç është përshkruar në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit. Prokurori i Shtetit më tutje konstaton se gjetjet faktike të gjykatës së shkallës së parë ishin bazuar në ekzaminimin dhe vlerësimin e plotë të dëshmive.

III GJETJET E GJYKATËS

A. Pranueshmëria e ankesës

Gjykata Supreme konstaton se ankesa e paraqitur në emër të të pandehurit është me kohë dhe e pranueshme. Aktgjykimi i ankimuar i është dorëzuar të pandehurit më 1 shkurt 2010 dhe ankesa e mbrojtjes ishte paraqitur në Gjykatën e qarkut në Pejë më 16 shkurt 2010, pra brenda afatit ligjor prej 15 ditëve të përcaktuar me Nenin 398 të KPPK-së. Ankesa ishte paraqitur nga Avokati mbrojtës, person i autorizuar.

Gjykata Supreme, megjithatë, konstaton se ankesa është e pabazuar. Kolegji tani do të vlerësojë secilin argument të ngritur në ankesën e mbrojtjes.

B. Përdorimi i deklaratës së A si dëshmi

Arsyeja e parë për ankesën është se aktgjykimi i ankimuar ishte i bazuar në dëshmi të papranueshme sa i përket deklaratës së dhënë nga dëshmitari A. Sipas ankesës kjo do të përbënte një shkelje të dispozitave të procedurës penale. Gjykata Supreme, megjithatë, nuk konstaton se çdo deklaratë e paraqitur para gjykatës së shkallës së parë si dëshmi është dashur të konsiderohej e papranueshme sipas dispozitave të KPPK-së.

Argumenti i mbrojtjes se disa nga deklaratat e dëshmitarit A ishin paraqitur apo siguruar në kundërshtim me aktvendimin e mëparshëm të Gjykatës Supreme të datës 2 qershor 2009 është plotësisht i pa meritë. Kolegji konstatoi se në faqen 6 të versionit në gjuhën Angleze të të njëjtit aktvendim Gjykata Supreme në mënyrë eksplicite thotë se nuk e ka konsideruar deklaratën e A si të papranueshme: *“Kodi [i Procedurës Penale] nuk përshkruan sanksionin e papranueshmërisë për shkeljen e rregullave mbi dëshmitarin bashkëpunues. Prandaj dëshmia është e pranueshme dhe deklaratat e dëshmitarit mund të përdoret si dëshmi.”*

Në vend të kësaj Aktvendimi i përmendur i Gjykatës Supreme (në faqe 6-7 të versionit në gjuhën Angleze) vërtetoi se deklarata e A është dashur të konsiderohej si deklaratë e dhënë në cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues dhe duke marrë parasysh efektet ligjore që ky status procedural ka mbi dëshminë e tillë: *“Gjykata Supreme konsideron se dëshmia e dhënë nga dikush (i dyshuar apo i pandehur) që duhej të dëgjohej nën formalitetet e përcaktuara për dëshmitarët bashkëpunues (dhe nuk është në shkelje të Kodit) nuk mund të ketë vlerë më të madhe dëshmuese se dëshmia e dhënë nga dikush (i dyshuar apo i pandehur) i deklaruar nga gjykata si dëshmitar bashkëpunues (neni 298 [i KPPK-së]).”*

Për statusin e A gjatë rigjykimit, Gjykata Supreme vëren se të gjitha hetimet penale kundër tij sa i përket vrasjes së S ishin ndërprerë para rigjykimit. Prandaj roli procedural i A ishte përcaktuar drejt nga trupi gjykues i rigjykimit – si dëshmitar.

Në ankesë mbrojtja tutje argumenton se gjatë dëgjimit të A para trupit gjykues të rigjykimit ishin bërë në mori referencash në deklaratat e mëhershme të të cilat, sipas mbrojtjes, i njëjti trup gjykues i kishte shpallur si dëshmi të papranueshme.

Dëgjimi i A gjatë rigjykimit ishte bërë më 12 nëntor 2009. Para këtij dëgjimi gjykata e shkallës së parë kishte vendosur se dy deklaratat e dhëna nga Avni Krasniqi ishin të papranueshme si dëshmi, përkatësisht deklaratat e datës 17 dhjetor 2002 dhe 11 gusht 2005. Megjithatë, Gjykata Supreme vëren se shënimet zyrtare të procedurës tregojnë se nuk ishte lejuar asnjë referim në deklaratat e përmendura më lart gjatë dëgjimit të A siç pretendohet nga mbrojtja.¹ Në të vërtetë, deklaratat e papranueshme ishin mbyllur si duhet në zarf para se ti bashkëngjiteshin shkresave të lëndës. Për këto arsye kjo bazë për ankesë konsiderohet e pabazuar.

C. A janë plotësuar kushtet ligjore për dispozitivin

Si arsye të dytë për ankesë mbrojtja argumentoi se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk përmban një përcaktim të saktë të veprës penale dhe se arsyetimi i atij aktgjykimi është i paqartë dhe kundërthënës sa i përket besueshmërisë së deklaratave të dëshmitarëve në kundërshtim të dispozitave të procedurës penale.

Në këtë pikë Gjykata Supreme nuk mundi të vërtetojë ndonjë mangësi substanciale sa i përket dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

Sipas neneve 396 paragrafit 4 dhe 391 paragrafit 1 të KPPK-së në rast të dënimit dispozitivi i aktgjykimit duhet të përmbajë të gjitha “të dhënat e domosdoshme”, në mes tjerash, veprën për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor bashkë me faktet dhe rrethanat që tregojnë natyrën penale të veprës së kryer dhe faktet dhe rrethanat mbi të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të procedurës penale. Trupi gjykues rikujton se kushtet ligjore të dispozitivit ishin vlerësuar disa herë nga Gjykata Supreme e Kosovës². Në aktgjykimet e mëparshme, Gjykata Supreme ka theksuar se dispozitivi është pjesë fundamentale e aktgjykimit. Kështu, elementet e përmendura më lart, duke përfshirë edhe rolin e të pandehurit, sjelljen e tij materiale dhe qëllimin e tij subjektiv, duhet të shprehen në një mënyrë shumë të qartë dhe pa dykuptimësi në mënyrë që të pandehurit dhe të gjithë personat e interesuar mund ta kuptojnë akuzën për të cilën i pandehuri është

¹ Gjatë procedurës më 12 nëntor 2009 referenca e vetme në deklaratat e papranueshme ishte bërë nga Avokati mbrojtës (në faqe 33 të versionit në gjuhën Angleze të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor) para se të ndërpritej nga kryetari i trupit gjykues.

² Shih p.sh. Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 21 korrik 2009 Ap-Kz 481/2008 O. Zyberaj e të tjerët dhe 2 korrik 2009 Ap.-Kz 394/2007 N. Gashi e të tjerët.

shpallur fajtor. Për më tepër, dispozitivi i aktgjykimit duhet të jetë i saktë dhe i qartë sa i përket kohës, elementeve materiale të krimit dhe të rrethanave në të cilat këto krime janë kryer.

Hyrja dhe dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar përmbajnë këto fakte dhe cilësime juridike lidhur me dënimin:

Në faqen e parë të aktgjykimit të ankimuar (versioni në gjuhën angleze) shkruan: "... *Idriz Gashi... i akuzuar...për veprën penale Krime lufte kundër popullatës civile në kundërshtim të nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, sepse në mëngjesin e 12 gushtit 1998, S femër shqiptare kosovare, është marrë në pyetje nga pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) të cilët kontrollonin zonën e fshatit Baran. Pastaj ajo është dërguar nga Idriz Gashi (i njohur si Galan) dhe A në një zonë të pyllëzuar, zonë të cilën vendasit e njohin si "Lugu i Isufit" ku pasua, Idriz Gashi e qëllloi për vdekje. Në Lugun e Isufit, në afërsi të fshatit Vranoc, Komuna e Pejës, më 12 gusht 1998.*"

Në faqen e dytë të aktgjykimit të ankimuar (versioni në gjuhën angleze) shkruan: "*Idriz Gashi është shpallur fajtor për Krime lufte kundër popullatës civile në kundërshtim të nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, neneve 3 dhe 147 të Konventës së Gjenevës 4 dhe nenit 4 të Protokollit Shtesë II të Konventës së Gjenevës, për vrasjen e S , të kryer në Lugun e Isufit në afërsi të fshatit Vranoc, Komuna e Pejës, më 12 gusht 1998.*"

Kolegji konstaton se në këtë rast dispozitiv është mjaft i qartë në deklarinimin e aktit për të cilin i pandehuri është shpallur fajtor dhe cilësimin të tij juridik, si dhe dispozitat në të cilat është bazuar dënimi. Prandaj, nuk është gjetur asnjë shkelje esenciale e procedurës penale në aktgjykimin e ankimuar në këtë drejtim. Një përshkrim më të hollësishëm të ngjarjeve dhe rrethanave që lidhen me veprën penale mund të gjenden në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata Supreme në veçanti i referohet, pa përsëritur, pikës F. të aktgjykimit të shkallës së parë ku cilësimi juridik i veprës penale si krim lufte është përshkruar në një mënyrë më të detajuar.

D. Vërtetimi i duhur i gjendjes faktike në bazë të dëshmive të paraqitura

Si pikë e tretë, ankesa mban qëndrimin se gjendja faktike është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë në një mënyrë jo të plotë dhe të gabuar. Në veçanti, ankesa ka kundërshtuar besueshmërinë e deklaratës së dëshmitarit A .

Sa i përket kësaj baze të ankesës, Gjykata Supreme nuk pajtohet me vlerësimin e bërë nga mbrojtja. Në të kundërtën, Gjykata Supreme vë në dukje se një pjesë e gjerë e aktgjykimit të ankimuar i është përkushtuar vlerësimit të provave të paraqitura gjatë rigjykimit (shih faqe 6-34, versioni anglisht).

Pas vlerësimit me kujdes të arsytimit të aktgjykimit të shkallës së parë, Gjykata Supreme ka arritur në përfundimin se gjykata e shkallës së parë ka kryer një vlerësim të plotë të arsyeshëm të provave dhe se gjykata e shkallës së parë në veçanti ka peshuar me kujdes provat e siguruar nga dëshmia e dëshmitarit A

Në faqen 29 të versionit në gjuhën angleze të aktgjykimit të shkallës së parë, gjykata ka theksuar dy mospërputhjet kryesore të cilat janë gjetur në deklaratën/deklaratat e A

“...dëshmia e A nuk është e besueshme në pjesën ku ai e përshkruan intervistën e viktimës në Baran. Deklarata e tij kundërshtohet nga versioni i dhënë nga C i cili patjetër duhet të konsiderohet si më i besueshëm për shkak të rolit të tij neutral në këto ngjarje”.

Më vonë në faqen 29 shkruan: “...dëshmia e A nuk është e besueshme kur ai raporton ngjarjet në Lugun e Isufit derisa viktima nuk te akoma gjallë...Kjo pjesë e dëshmisë kundërshtohet nga dëshmia e D. e cila është shumë e qartë...duke thënë se kanë qenë dy persona të cilët e kanë përcjellë viktimën në pyll.”

Gjykata e shkallës së parë vazhdon vlerësimin e besueshmërisë së deklaratës/deklaratave të A në tërësi duke arritur në përfundim që, edhe pse disa pjesë të dëshmisë së tij nuk janë të besueshme, kjo nuk do të thotë se e tërë dëshmia e tij duhet që të mos merret parasysh. Gjykata e shkallës së parë pastaj ka vlerësuar se pjesa e dëshmisë së A që e identifikon Idriz Gashin, si personi që qëlloi S ishte e qartë, koherente në brendi dhe e vërtetuar edhe nga dëshmitë e tjera (pranimin e Idriz Gashit në kohën e varrimit të parë të viktimës).

Gjykata Supreme gjen se në përcaktimin e fajit të Idriz Gashit përtej çdo dyshimit të arsyeshëm, gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh si duhet efektin kumulativ të pjesëve të ndryshme të provave. Dënimi nuk ka qenë ekskluzivisht apo madje deri në pjesën vendimtare i bazuar vetëm në dëshminë e A.

Gjykata e shkallës së parë u mbështet në dëshmitë e A U, H, U dhe A si dëshmi që tregojnë se i pandehuri kishte pranuar vrasjen e S në Lugun e Isufit, në kohën e varrimit fillestar të viktimës. Në përfundimin se i pandehuri në të vërtetë kishte vrarë viktimën Sanije Balaj, gjykata e shkallës së parë ka gjetur tre elemente vërtetuese në këtë pranim (faqe 27 - 28 versioni në gjuhën angleze i aktgjykimit të shkallës së parë) si vijon:

- Së pari: dëshmitë nga deklaratat e A U, H, U dhe A sugjerojnë se fletorja e viktimës (që përmban disa nga emrat e personave serb) ishte në posedim të të pandehurit në kohën e varrimit të parë të viktimës;
- Së dyti: fakti i padiskutueshëm se S u shoqërua nga objekti i UÇK-së në Baran nga i pandehuri dhe A (kjo është edhe hera e fundit që S është parë e gjallë nga ndonjëri prej dëshmitarëve para se ajo ishte dërguar në Lugun e Isufit ku ajo u ekzekutua); dhe

- Së treti: fakti tjetër i padiskutueshëm se Idriz Gashi ka qenë i pranishëm -i armatosur rëndë dhe ka lëshuar urdhra për ata që ishin duke iu afruar vendit - Lugut të Isufit, në kohën kur mbetjet trupore të S... u varrosën për herë të parë.

Sa i përket pikës së fundit, është e qartë për Gjykatën Supreme se varrimi fillestar i S... u zhvillua në një mënyrë të ngutshme vetëm me qëllim të fshehjes së vrasjes, e cila shpjegon jo vetëm praninë, por edhe rolin aktiv të të pandehurit në vendin e varrimit.

Dispozitat e procedurës penale përcaktojnë se gjykata duhet të theksojë në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte ajo i konsideron të provuara apo të pa provuara, si dhe arsyet për këtë. Gjykata gjithashtu duhet që, në veçanti, të bëjë një vlerësim të besueshmërisë të dëshmimeve kontradiktore. Gjykata Supreme gjen se vlerësimi i provave nga gjykata e shkallës së parë është bërë në përputhje me kushtet ligjore dhe në mënyrë të kujdesshme, transparente dhe bindëse. Në përfundim, Gjykata Supreme nuk gjen vërtetim të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike në aktgjykimin ankimuar.

E. Ligji i aplikueshëm, cilësimi juridik dhe dënimi

Për pikën e pretenduar të shkeljes së Ligjit Penal, Gjykata Supreme do ta vlerësojë cilësimin juridik të veprës për të cilën Idriz Gashi është dënuar, si dhe vendimin mbi dënimin.

Sipas nenit 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale do të zbatohet për kryerësit. Në rast të një ndryshimi në ligjin e aplikueshëm para një vendimi përfundimtar, ligji më i favorshëm për kryesin e veprës do të zbatohet.

Më 12 gusht 1998, kur është kryer vepra penale, Kodi Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (Kodit Penal i RSFJ-së), ishte në fuqi. KPK-ja ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004, pra pas kryerjes së veprës penale dhe para vendimit të formës së prerë.

Gjykata Supreme gjen se sjellja për të cilën i pandehuri ka qenë i dënuar aktualisht bie nën nenin 118 të KPK-së të titulluar "Krimet e Luftës në kundërshtim të rëndë me Konventat e Gjenevës". Për këtë veprë penale ligji parasheh një dënim me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim afatgjatë.

Nga ana tjetër, neni 142 në lidhje me nenin 38 të Kodit Penal të RSFJ-së parasheh një dënim prej së paku pesë (5) vjet ose me burgim për një periudhë prej 20 vjetësh për veprën penale të Krime Luftë kundër popullatës civile. Bazuar në këtë krahasim Kodi Penal i RSFJ-së është më i favorshëm për të pandehurin dhe për këtë arsye është aplikuar në mënyrë të duhur nga gjykata e shkallës së parë.

Pas një vlerësimi të plotë të aktgjykimit të ankimuar dhe materialeve të tjera në shkresat e lëndës, Gjykata Supreme është plotësisht e bindur se kushtet ligjore për cilësimin e vrasjes së S... si një krim lufte janë plotësuar.

Kushtet paraprake që një vepër penale të cilësohet si krim luftime sipas nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së janë shkeljet e rregullave të së drejtës ndërkombëtare gjatë një konflikti të armatosur. Në këtë kontekst rregullat e aplikueshme të së drejtës ndërkombëtare i referohen rregullave të detyrueshme të së drejtës humanitare ndërkombëtare të përcaktuara në Konventën e Gjenevës 4 në lidhje me Mbrojtjen e Personave Civilë në Kohë Luftë të 12 gushtit 1949 dhe Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, dhe në lidhje me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve Jo-Ndërkombëtare të Armatosura (Protokolli II), të 8 qershorit 1977, përkatësisht neneve 3, 147 dhe 4.

Sa i përket konceptit të konfliktit të armatosur të brendshëm, Gjykata Supreme i referohet vendimit të Dhomës së Apelit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavinë (GjNPJ) në rastin e ashtuquajtur Tadiq³ ku Dhoma Apelit e GjNPJ-së konstatoi se " një konflikt i armatosur ekziston sa herë që ka përdorim të forcës së armatosur në mes të shteteve ose të dhunës së armatosur të zgjatur në mes të autoriteteve qeveritare dhe grupeve të organizuara të armatosura ose midis grupeve të tilla brenda një Shteti." Dhoma e Apelit ka deklaruar më tej se e drejta ndërkombëtare humanitare aplikohet nga fillimi i konflikteve të tilla të armatosura dhe shtrihet përtej ndërprerjes së armiqësisë deri në arritjen e një zgjidhjeje paqësore. Deri në atë moment, e drejta ndërkombëtare humanitare vazhdon të zbatohet në të gjithë territorin nën kontrollin e një pale, pavarësisht nëse në atë vend ka pasur luftime apo jo.

Gjykata Supreme i referohet një jurisprudence të konsoliduar – të gjykatave ndërkombëtare dhe vendore - që kanë konstatuar se në fakt një konflikt i armatosur ka ekzistuar në mes të një grupi të organizuar të armatosur të quajtur UÇK dhe forcave serbe të Republikës Federative të Jugosllavisë në Kosovë, gjatë kryerjes së këtij akti kriminal.⁴

Për më tepër, Gjykata Supreme vëren se pyetja nëse viktimia S ishte pjesëtare e popullatës civile dhe si e tillë një person i mbrojtur sipas rregullave të përmendura më lart të së drejtës ndërkombëtare humanitare nuk është kontestuar gjatë procedurës. As nuk është kontestuar ndonjëherë nëse i pandehuri, në atë kohë, ka qenë pjesëtar i UÇK-së.

Kushti i fundit për aplikimin e rregullave të së drejtës humanitare ndërkombëtare është lidhja që ekziston midis krimit dhe konfliktit të armatosur. Krimi i supozuar nuk duhet të ketë ndodhur në një kohë dhe vend në të cilin kishte luftime, për aq kohë sa veprimet e autorit të krimit ishin të lidhura ngushtë me armiqësitë që ndodhin në territoret e kontrolluara nga palët në konflikt. Ekzistenca e kësaj marrëdhënie të ngushtë ndërmjet krimit dhe konfliktit të armatosur do të konstatohet ku mund të tregohet se konflikti ka luajtur një rol të konsiderueshëm në aftësinë e autorit të krimit për të kryer krimin, vendimin e tij apo të saj për ta kryer atë, mënyrën në të cilën është kryer, ose qëllim për

³ Lënda Prokurori kundër Tadiq, Nr. IT-94-1-AR72, Vendimi mbi propozimin e mbrojtjes për ankesën e ndërmjetme mbi juridiksionin, 2 tetor 1995, paragrafi 70.

⁴ Për shembull shih lëndën Prokurori kundër Milutinovic et al, IT-05-87-T, Aktgjykimi Dhomës së gjykimin, 26 shkurt 2009, paragrafi 841 dhe Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimi i 10 prillit 2009 Ap. – Kz. 371/2008 Selim Krasniqi et al.

të cilin është kryer. Gjykata Supreme gjen se gjykata e shkallës së parë ka vënë në dukje në mënyrë të saktë në faqen 36 të versionit në gjuhën angleze të aktgjykimit të ankimuar se: *"Konflikti i armatosur ka luajtur një rol fundamental në aftësinë e të pandehurit për të kryer krimin. Vendimi i Idriz Gashit për vrasjen e S... ishte i lidhur në mënyrë të qartë me konfliktin. Në fakt arsyeja e pretenduar për veprimin kundër viktimës ishte për shkak bashkëpunimit të saj të supozuar me serbët ... "*

Së fundi, sa i përket dënimit, Gjykata Supreme konstaton se dënimi me burg i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është i duhur duke marrë parasysh rrethanat përkatëse në lidhje me veprën penale dhe të pandehurit. Në përfundim, nuk ka shkelje të Ligjit Penal në aktgjykimin e shkallës së parë.

IV PËRFUNDIM

Pasi që Gjykata Supreme sipas detyrës zyrtare nuk e njeh çdo shkelje të ligjit (sipas nenit 415 paragrafit 1 të KPPK-së), e cila nuk është objekt i ankimit nga ana e mbrojtjes, dhe në bazë të të gjitha arsyeve të lartpërmendura është vendosur si në dispozitiv.

**Sot më 25 nëntor 2010.
Ap.-Kž. Nr. 108/2010**

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Kryetari i kolegjit


Martti Harsia

Anëtar i kolegjit

Gerrit-Marc Sprenger

Anëtare e kolegjit

Marije Ademi



Procesmbajtës

Sampsa Hakala

Anëtar i kolegjit

Lars Dahlstedt

Anëtare e kolegjit

Nesrin Lushta